



PALLTOJA E HUMBUR

Nga Shilla Kindredi

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

“Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit” (Doktrina e Besëlidhje 64:10).

“Ma, palltoja ime nuk është më këtu!” tha Bredi. Ishte koha për të shkuar në shtëpi pas kishë, por Bredi nuk mund ta gjente pallton e tij te varësja e rrobave.

“A je i sigurt se e vare këtu?” pyeti Mamaja.

“Po. Ishte pikërisht këtu.” Palltoja e Bredit ishte blu dhe e kuqe e ndezur. Ishte e vështirë të mos e shihje.

“Ndoshta e kanë lëvizur. Le të shohim përreth ndërtesës”, tha Babai.

Mami, Babi dhe Bredi u ndanë për të kontrolluar në dhoma të ndryshme. Ata panë te kutia e gjërave të humbura dhe të gjetura, te godina kishtare, te klasa e Shkollës të së Dieles së Bredit, te klasa e Fillores dhe në çdo varëse palltosh. Madje panë edhe në tualete, por nuk e gjetën atë.

“Dikush ndoshta e mori atë padashje. Jam i sigurt se do të ta kthejnë javën tjetër sapo ta kuptojnë se nuk është e tyrja”, tha Babai.

“Ndërkohë mund të veshësh pallton tënde të vjetër”, tha Mamaja.

Bredi rrudhi vetullat. Atij nuk i pëlqente palltoja e vjetër. Ishte e hollë, i kishte dalë boja dhe ishte shumë e vogël për të. Atij i pëlqente shumë se si palltoja e re e kuqe dhe blu e bënte të dukej si një superhero.



“Dikush ndoshta e pa se sa e bukur ishte palltoja ime dhe e vodhi”, mendoi Bredi. Si mund të ndodhë kjo në kishë? Çdonjëri atje supozohet të jetë i ndershëm. Bredi nuk do ta lejonte atë hajdut të largohej me pallton. Ai kishte një plan. Të dielën tjetër, ai do të kontrollonte me kujdes për të parë se kush po e mban-te veshur pallton e tij. Pastaj ai do ta rrokte sërish dhe do të bërtiste: “Ndalo, hajdut!” Atyre do t’u vinte keq që e morën me të parën.

Bredi mezi po e priste të dielën për ta përmbushur planin e tij. Por e diela e ardhshme ishte shumë e nxehtë për të veshur pallto dhe ashtu ishte edhe e diela tjetër.

Pas dy të dielash, Bredi i vështroi i dyshimtë në Fillore të gjithë djemtë, duke vrarë mendjen se kush ia vodhi pallton. Mos ishte ai djali i gjatë? Ose ndoshta ishte vajzë. Ndiente se nuk mund t’i besonte askujt. Bredit nuk i pëlqente ajo lloj ndjenje.

Pas kishë Bredi shpejtoi rreth ndërtesës duke parë familjet që vishnin palltot e tyre. Por nuk e pa pallton e tij asgjëkund. Ai madje e kontrollloi sërish kutinë me

gjëra të humbura dhe të gjetura . . . por nuk kishte asnjë pallto. Ku mund të ishte vallë?

Rrugës për në shtëpi, Bredi mendoi një plan të ri. Ai do të lutej. Ai e dinte se Ati Qiellor mund t’i gjente gjërat e humbura. Atë natë Bredi u lut dhe tha: “Atë Qiellor, të lutem më thuaj se kush ma mori pallton. E dua mbrapsht.”

Bredi priti që t’i vinte ndërmend emri ose fytyra e hajdutit. Por përkundrazi ai filloi të mendonte për shokun e tij, Karlin. Bredi zakonisht ulej afër Karlit në Fillore. Ata bënin shaka dhe qeshnin shumë së bashku. Por Karli nuk kishte qenë në kishë prej pak javësh. Bredin e kishte marrë malli për të.

Po sikur *Karli* t’ia kishte marrë pallton? Ndoshta Karli tani kishte frikë që të vinte në kishë sepse mendonte se Bredi nuk do të ishte më shoku i tij. Bredi donte që Karli të vinte përsëri në Kishë. Nëse Karli do ta kishte marrë pallton e tij, Bredi vendosi se nuk do t’i bërtiste atij. Ai do ta falte atë.

Bredi hipi në krevat duke u ndier më mirë.

Të dielën tjetër në Fillore, Karli nuk ishte atje por ishte një djalë i ri. Ai kishte veshur një kollare me viza të kuqe dhe blu.

“E bukur kollarja”, tha Bredi, duke u ulur afër djalit të ri. “Të bën të dukesh si një superhero.”

Djali buzëqeshi.

Edhe Bredi buzëqeshi. Ai nuk po kërkonte më për hajdutë. Ai po kërkonte miq. ●

Autorja jeton në Ajoua, SHBA.